

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 09.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Vazhdimi i sinjalit satelitor për pajiset LRIT për anijet me flamur shqiptar për një periudhë kohore 2- vjeçare".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 63724100-1, 63726600-0.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,833,300 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe të nenit 26 të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: "I Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në

vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: *Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.* Pika 2 Neni 83: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe mbështetje të nenin 30 të V.K.M-së nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 2, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021 “Rekomandim hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Vlera e kërkuar është brenda kufijeve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që Autoritetet Kontraktore të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoritetet Kontraktore në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për Autoritetet Kontraktore, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a. 1 (një) specialist i diplomuar në degë të teknologjise se informacionit IT/ informatikes/ inovacionit/ elektronikës apo cdo arsimim i ngjashëm. Per keta punonjës te paraqitet diploma dhe kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.
- b. 2 (dy) specialist të Sistemit LRIT. Për keta punonjës të paraqitet diplomë përkatëse, kontrata e punes e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues si dhe çdo certifikate/ transkriptim/ vertetim apo çdo dokument tjetër ligjore që verteton që është specialist për sistemit LRIT.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, shkronjat b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të

kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi disponimin e personelit të nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për disponimin e personelit teknik përbën një element thelbësor të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ofertues dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit. Fusha e diplomimit e kërkuar është përcaktuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe jo kufizuese, duke përfshirë teknologjinë e informacionit, informatikën, elektronikën, inovacionin, elektronikës apo fusha të tjera të ngjashme që lidhen me realizimin e shërbimit objekt prokurimi, duke garantuar kështu pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurë.

Kërkesa për një specialist me formim në teknologjinë e informacionit, informatikë, elektronikë ose fushë të ngjashme justifikohet nga nevoja për të garantuar kapacitetet teknike për administrimin, monitorimin dhe trajtimin e problematikave që lidhen me transmetimin e të dhënave përmes sistemit të komunikimit dhe suport mbi infrastrukturen aktuale. Kërkesa për dy specialistë të Sistemit LRIT lidhet drejtpërdrejt me specifikën e shërbimit dhe nevojën për personel me njohuri të specializuara për funksionimin, monitorimin dhe mbështetjen teknike të këtij sistemi. Disponimi i dy specialistëve synon gjithashtu garantimin e vazhdimësisë së kapacitetit profesional gjatë gjithë periudhës së kontratës dhe shmangien e varësisë së ofrimit të shërbimit nga një burim i vetëm njerëzor. Kërkesa për paraqitjen e diplomës, kontratës së punës dhe dokumentacionit që provon specializimin në LRIT synon verifikimin objektiv të formimit profesional dhe disponueshmërisë së personelit të deklaruar, ndërsa pranimi i dokumenteve të ndryshme provuese dhe i arsimimit të ngjashëm shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

SSH EN ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme).

SSH EN ISO/IEC 27001:2023 ‘Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit’ ose ekuivalente (e vlefshme).

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten: Çertifikatat përkatëse, objekti i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë certifikimin SSH EN ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalent, është përcaktuar me qëllim garantimin e një niveli të qëndrueshëm dhe të kontrollueshëm të cilësisë në ofrimin e shërbimit objekt prokurimi. Duke qenë se kontrata ka për objekt vazhdimin e sinjalit satelitor për pajisjet LRIT të anijeve me flamur shqiptar, shërbimi kërkon administrim dhe kontroll të vazhdueshëm të proceseve, menaxhim të

problematikave teknike dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës kontraktore. Certifikimi sipas SSH EN ISO 9001:2015 shërben si tregues i ekzistencës së një sistemi të standardizuar të menaxhimit të cilësisë dhe të proceseve të dokumentuara për kontrollin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit. Për rrjedhojë, kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetet dhe procedurat e nevojshme për ofrimin e shërbimit në mënyrë të qëndrueshme, të kontrolluar dhe me cilësi të përshtatshme me rëndësinë e shërbimit LRIT.

- Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë certifikimin SSH EN ISO/IEC 27001:2023 “Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë – Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ose ekuivalent, të vlefshëm, është përcaktuar për të garantuar që shërbimi objekt prokurimi të realizohet në përputhje me kërkesat e nevojshme për sigurinë, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit që përpunohet dhe transmetohet në kuadër të sistemit LRIT. Duke qenë se shërbimi përfshin transmetimin dhe administrimin e të dhënave të identifikimit dhe pozicionimit të anijeve nëpërmjet komunikimit satelitor, ekziston nevoja për masa të përshtatshme organizative dhe teknike për mbrojtjen e informacionit nga akseset e paautorizuara, humbja, ndryshimi apo ndërhyrjet e paautorizuara. Certifikimi sipas SSH EN ISO/IEC 27001:2023 dëshmon ekzistencën dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të bazuar në procese të strukturuar për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit.

2.3.5 Ofertuesi të paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ku të autorizohet operatori për kryerjen e shërbimeve respektive të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesa që ofertuesi të paraqesë autorizim nga prodhuesi, nëpërmjet të cilit të autorizohet për kryerjen e shërbimeve respektive që përfshihen në objektin e prokurimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar me qëllim garantimin e origjinës, legjitimitetit dhe kapacitetit teknik të ofertuesit për ofrimin e shërbimit të lidhur me sistemin LRIT. Duke pasur parasysh natyrën specifike dhe teknologjike të shërbimit, autorizimi synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon mbështetjen dhe të drejtën përkatëse nga prodhuesi për kryerjen e shërbimeve, ndërhyrjet teknike, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe asistencën e nevojshme për pajisjet dhe/ose komponentët e sistemit që lidhen me objektin e kontratës, duke reduktuar rrezikun e ndërhyrjeve nga subjekte të paautorizuara dhe të cenimit të funksionalitetit apo sigurisë së sistemit LRIT. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe synon të garantojë realizimin e shërbimit nga një subjekt që ka marrëdhënie të verifikueshme me prodhuesin dhe mbështetjen e nevojshme teknike për teknologjinë përkatëse. Përcaktimi i autorizimit për territorin e Republikës së Shqipërisë lidhet me nevojën për të garantuar që shërbimi të mund të ofrohet dhe të mbështetet në mënyrë efektive për anijet me flamur shqiptar gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Përfitues (Drejtorja e Përgjithshme Detare), për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialist I fushes për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit me

nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke u bazuar ne pervojen dhe eksperiencen e viteve te kaluara qe ka rezultuar e sukseshme. Specifikimet teknike, për shërimin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 42, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afatin përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP, për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt.